**LIGJ**
**Nr.10 366, datë 16.12.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008 "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar, ndryshojnë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ndalohet importimi në Republikën e Shqipërisë i mbeturinave urbane me kod doganor 38251000, llumrave të ujërave të zeza me kod doganor 38252000 dhe mbeturinave klinike me kode doganore 38253000, 38254100 dhe 38254900.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6839, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

ANEKSI 1

| Kodi NK 2010 | Përshkrimi | Tarifa ishte (%) | Tarifa bëhet (%) |
|---|---|---|---|
| 02062200 | Mëlçi | 10 | 5 |
| 02063000 | Prej derri, i freskët apo i ftohur | 10 | 5 |
| 02064100 | Mëlçitë | 10 | 5 |
| 02064900 | Të tjera | 10 | 5 |
| 07081000 | Bizele (Pisum sativum) (nga 1 qershori deri 31 gusht) | 15 | 10 |
| 08061090 | Të tjera (nga 1 janari deri 14 korrik) | 10 | 5 |
| 08061090 | Të tjera (nga 1 nëntori deri 31 dhjetor) | 10 | 5 |
| 09041100 | As i bluar as i grirë | 15 | 10 |
| 09042030 | Të tjera | 15 | 10 |
| 09093000 | Farat e barit të gjumit | 15 | 10 |
| 09094000 | Farat e qimnonit | 15 | 10 |
| 09095000 | Farat e koprës, fara dëllinje | 15 | 10 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 09101000 | Xenxerfill | 15 | 10 |
| 28520000 | Përbërje inorganike dhe organike të mërkurit, duke përjashtuar amalgamet | 2 | 0 |
| 35071000 | Mullez dhe koncentratet e tij | 10 | 6 |
| 35079030 | Lipaze lipoproteine; proteaze alkalin prej aspergilus | 10 | 6 |
| 35079090 | Të tjera | 10 | 6 |
| 36041000 | Fishekzjarrët | 15 | 6 |
| 36049000 | Të tjera | 15 | 6 |
| 36050000 | Shkrepëset, përveç artikujve piroteknikë të kreut 3604 | 15 | 6 |
| 38210000 | Mjedis i përgatitur për kulturat për zhvillimin apo mirëmbajtjen e mikroorganizmave (përfshi viruset dhe të ngjashmet) ose qelizave të bimëve, njeriut apo kafshëve | 2 | 0 |
| 38251000 | Mbeturinat urbane | 2 | 0 |
| 38252000 | Llumrat e ujërave të zeza | 2 | 0 |
| 38253000 | Mbeturinat klinike | 2 | 0 |
| 38254100 | Të halogjenizuar | 2 | 0 |
| 38254900 | Të tjera | 2 | 0 |
| 38255000 | Mbeturina të lëngjeve pastruese të metaleve, lëngjeve hidraulike, lëngjeve të frenave dhe antifrize | 2 | 0 |
| 38256100 | Që përmbajnë kryesisht përbërës organikë | 2 | 0 |
| 38256900 | Të tjera | 2 | 0 |
| 38259090 | Të tjera | 2 | 0 |
| 44219091 | Prej panele fibrash | 10 | 0 |
| 44219098 | Të tjera | 10 | 0 |
| 68128010 | Fibra të fabrikuara; përzierje me një bazë të asbestit apo me një bazë të asbestit dhe të karbonatit të magnezit | 15 | 10 |
| 68128090 | Të tjera | 15 | 10 |
| 68129910 | Fibra të fabrikuara asbesti; përzierje me një bazë asbesti apo me një bazë asbesti dhe karbonat magnezi | 15 | 10 |
| 68129990 | Të tjera | 15 | 10 |
| 73066192 | Me një trashësi muresh jo më tepër se 2 mm | 5 | 0 |
| 73066199 | Me një trashësi muresh më tepër se 2 mm | 5 | 0 |
| 73066990 | Të tjera | 5 | 0 |
| 84672110 | Që funksionojnë pa një burim të brendshëm energjie | 2 | 0 |
| 84672191 | Elektropneumatike | 2 | 0 |
| 84672199 | Të tjera | 2 | 0 |
| 84672210 | Sharra elektrike me zinxhirë | 2 | 0 |
| 84672230 | Sharrë disk | 2 | 0 |
| 84672290 | Të tjera | 2 | 0 |
| 84701000 | Kalkulatorët elektronikë, të aftë të veprojnë pa një burim të jashtëm fuqie elektrike dhe makina të përmasave të xhepit regjistruese, riprodhuese | 2 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | dhe shfaqjeje të dhënave me funksione kalkuluese | | |
| 85193000 | Gramafonet | 10 | 0 |
| 85489090 | Të tjera | 2 | 0 |
| 90069900 | Të tjera | 10 | 0 |
| 99000000 | Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare | - | 2 |